

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI**

**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
'POLYGLOT - AL' SH.P.K.**

Sot, në datën 30.04.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë) ortakët themelues:

- **Z. Xhelil BAJRAMI**, shtetas shqiptar, lindur me 21.08.1973, në Tetovë, Maqedoni, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr 024531002 (dhe numër personal: H30821037J);
- **Znj. Imelda DEMBACAJ**, shtetase shqiptare, lindur me 22.01.1984, në Lezhë, banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) me nr. 033271359 (dhe numër personal: 145122055D);

kanë vendosur të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të mëposhtme.

**KAPITULLI I
EMRI, FORMA LIGJORE E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

Neni 1

THEMELIMI DHE FORMA LIGJORE

- 1.1 Emri i shoqërisë është '**POLYGLOT - AL**' Sh.p.k. (në vijim referuar si "**Shoqëria**");
- 1.2 Shoqëria është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar ('Ligji i Shoqërive Tregtare').
- 1.3 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 1.4 Aktiviteti i Shoqërisë do të ushtrohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të këtij Akti Themelimi dhe Statuti.

Neni 2

SELIA

- 2.1 Selia e ushtrimit të aktivitetit tregtar të Shoqërisë është në adresën: "Rruga Besim Imami, Pallati nr.5, Shkalla nr.1, Tiranë, Shqipëri". Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë.
- 2.2 Shoqëria, me miratim të Asamblesë së Përgjithshme, mund të hape dege të saj ose zyra perfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, seli sekondare të Shoqërisë.



Neni 3

OBJEKTI I SHOQËRISË

3.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të jetë:

- a) Kërkim, ideim, planifikim, projektim, zhvillim, monitorim dhe publikim iprogramacioneve softwaredhe hardwaresi dheimpianteve te çdollojidhe tipi, si dhe te infrastrukturës mbështetëse;
- b) Krijimi isoftware-vepër çdo lloj platformëdhe te çdo lloj tipi, si dhe faqeve dhe aplikacioneve web;
- c) Shërbimet këshillimi, përfaqësimi, dhe ndërmjetësimi me palë të treta, shoqëri të huaja dhe vendase;
- d) Shitje – blerje, Import-eksport, dhe dhenie me qira të programacionevesoftware dhe hardware,impianteve te çdollojidhe tipi, si dhe te infrastrukturës mbështetëse;
- e) Çdo lloj aktiviteti tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, veprime bankare dhe financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, si dhe konsulenca dhe asistenca teknike të dobishme për arritjen e objektivit të Shoqërisë përmëndur më sipër; si dhe
- f) Çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

4.1 Shoqëria do të themelohet për një kohëzgjatje (afat) të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KAPITULLI II

KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT/PJESËT E KAPITALIT

Neni 5

KAPITALI THEMELTAR DHE ORTAKËT

5.1 Kapitali i themeltar i Shoqërisë është 1.000 Lekë (një mijë lekë), i ndarë në 2 kuota me vlerë nominale 500 (pesëqind) lekë kuota, të zotëruar nga Ortakët themelues si më poshtë vijon:

- **Z. Xhelil BAJRAMI**, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr 024531002 (dhe numër personal: H30821037J), në cilësinë e ortakut themelues, zotëron 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të vlerës së kuotave në kapitalin fillestar të Shoqërisë, të barabartë me 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 600 (gjashtëqind) lekë;
- **Znj. Imelda DEMBACAJ**, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) me nr. 033271359 (dhe numër personal: I45122055D), në cilësinë e ortakut themelues, zotëron 40 % (dyzetë përqind) të vlerës së kuotave në kapitalin fillestar të Shoqërisë, të barabartë me 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 400 (katërqind) lekë.



2

- 5.2 Kapitali themeltar është derdhur tërësisht nga ortakët themelues.
- 5.3 Kuotat e Ortakëve të Shoqërisë janë lirisht e transferueshme sipas legjislacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 5.4 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogelohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me parashikimet e këtij Statuti, dhe dispozitave të Ligjit të Shoqërive Tregtare.
- 5.5 Ortakët e Shoqërisë përgjigjen për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të saj.
- 5.6 Cdo kuote i jep të drejtën e një vote cdo Ortaku, në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve (Asambleja e Përgjithshme), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, sikundër të drejtat e parashikuara nga ky Statut, dhe dispozitave ligjore të Ligjit të Shoqërive Tregtare.

KAPITULLI III **ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

Neni 6

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, ligjërisht e thirrur dhe rregullisht e mbledhur është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e saj, të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitave të këtij Akti Themelimi dhe Statuti, janë të detyrueshme për t'u ndjekur dhe zbatuar;
- 6.2 Asambleja e Përgjithshme ka këto funksione:
- a) Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikqyr zbatimin e tyre nga Administratori duke përfshirë raportimet financiare;
 - b) Emëron dhe shkarkon Administratorin(-ët) dhe zëvendësve të tij, Drejtorin(-ët) e Financës, ekspertin(-ët) kontabël dhe/ose likuiduesin(-ët) e Shoqërisë, ;
 - c) Përcakton pagat dhe shpërblimet për Administratorin(-ët), ekspertët(-ët) kontabël dhe likuiduesit(-ët) e Shoqërisë;
 - d) Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
 - e) Merr vendim për ndryshimet e këtij Akti Themelimi dhe Statuti të Shoqërisë;
 - f) Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, pjestimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, dividendëve;
 - g) Merr vendim për ristrukturimin ose prishjen/likuidimin e Shoqërisë;
 - h) Merr vendim për hapjen e degëve dhe/ose zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë;
 - i) Merr vendim për themelimin e shoqërive të reja Joint Venture ose aleanca që lidhen me shitjen blerjen, pjesëmarrjen dhe investimin në projekte ekzistuese dhe të reja;

- j) Vendos për dhënien dhe marrjen e fondeve hua ose paradhënie nga ortakët dhe administratorët për nevoja personale dhe për financim biznesi;
- k) Miraton kërkesat e reja dhe vendos për rinovimin e kërkesave ekzistuese për financim;
- l) Vendos për bllokimin dhe lënien peng të pasurive të paluajtshme pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- m) Miraton buxhetin vjetor të shoqërisë si dhe investimet dhe shpenzimet të cilat nuk janë parashikuar në buxhetin vjetor;
- n) Vendos për blerjen e pasurive të paluajtshme;
- o) Miraton blerjet, shitjet, nënshkrimin e kontratave me palë të treta për punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër, si dhe shpenzimet e paparashikuara në buxhetin vjetor të Shoqërisë, për një vlerë mbi 5.000 EUR (pesë mijë Euro) ose vlerës ekuivalente në Lekë (në datën e transaksionit).
- p) Miraton planin e kontrollit të brendshëm dhe rregulloreve të Shoqërisë; si dhe
- q) Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuara nga ligji apo Statuti.

Neni 7

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

- 7.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik do të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 7.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga një a me shume ortake qe perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqërisë;
- 7.3 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e kuotave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë. Për çështjet e tjera, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e kuotave të ortakëve pjesëmarrës. Cdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- 7.4 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
- 7.5 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 3 dhe 4 të këtij neni, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 8

REGJISTRI I VENDIMEVE




- 8.1 Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme duhet të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen. Regjistri i Vendimeve duhet të mbahet nga Administratori dhe çdo regjistrim duhet nënshkruar nga Administratori.

Neni 9

ADMINISTRATORI

9.1 *Administratori dhe mandati përkatës:*

9.1.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

9.1.2 Administratori i Shoqërisë është: **Znj. Imelda DEMBACAJ**, shtetase shqiptare, lindur me 22.01.1984, në Lezhë, banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) me nr. 033271359 (dhe numër personal: I45122055D).

9.1.3 Mandati i Administratorit është 5 (pesë) vjet, i rinovueshëm dhe zgjatet deri në vendimin pasardhës të Asamblesë së Përgjithshme, që vendos për revokimin, rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit(eve) të ri.

9.2 *Të drejtat e Administratorit:*

9.2.1 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.

9.2.2 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- a) Administron veprimtarinë e Shoqërisë duke zbatuar politikatat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
- b) Përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me çdo palë të tretë.
- c) Merr masa për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumentave.
- d) Përgatit dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore dhe bilancet e konsoliduara, përgatit raportin e ecurisë dhe ia dorëzon këto të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve Asamblesë së Përgjithshme për miratim.
- e) Krijon sistemin e paralajmërimit në lidhje me rrethana, që kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë.
- f) Dorëzon në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dokumentat dhe të dhënat e Shoqërisë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.
- g) I raporton Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë.
- h) Kryen blerjet, shitjet, nënshkrimin e kontratave me palë të treta për mallra, punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër e cila nuk është nën përgjegjësinë direkte të Asamblesë së Përgjithshme deri në vlerën e barabartë me 5.000 EUR (pesë mijë Euro) ose vlerës ekuivalente në Lekë dhe/apo ndonjë monedhë tjetër (në datën e transaksionit); mbi këtë vlerë do të kërkohet/nevojitet konfirmimi (miratimi) me shkrim nga Ortaku që përfaqëson shumizën e kuotave të kapitalit të Shoqërisë.



- i) Miraton investimet dhe shpenzimet e paparashikuara në buxhetin vjetor të Shoqërisë deri në një vlerë të barabartë me mbi 5.000 EUR (pesë mijë Euro) ose vlerës ekuivalente në Lekë (në datën e transaksionit), mbi këtë vlerë do të merret miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.
- j) Kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.
- k) Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure një person të tretë për të përfaqësuar Shoqërinë dhe për të nënshkruar çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.
- l) Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 10

EKSPERTI(ËT) KONTABËL TË JASHTËM

- 10.1 Pasqyrat financiare të Shoqërisë do të auditohen të paktën një herë në vit nga një, apo më shumë, ekspert kontabël të jashtëm. Me marrjen në dorëzim të raportit përkatës të auditimit, Administratori i Shoqërisë do të marrë të gjitha masat përkatëse për ndreqjen e parregullësive të konstatuara nga raporti.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 11

VITI FINANCIAR

- 11.1 Viti financiar fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Viti i pare financiar nis në datën e themelimit të Shoqërisë.
- 11.2 Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 11.3 Bilanci dhe raporti i ecurisë i hartuar prej Administratorit dhe raporti që, eventualisht, hartohet prej ekspertit kontabël të emëruar, miratohen prej Asamblesë së zakonshme me shumicën e votave.

Neni 12

SHPËRNDARJA E FITIMEVE

- 12.1 Pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimit, nëse ka. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

KAPITULLI V

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË



Neni 13

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

- 13.1 Në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos për prishjen e Shoqërisë do të emërohen një ose më shumë likuidues.
- 13.2 Eksperti kontabël i Shoqërisë do të emërohet nga Asambleja e Përgjithshme nëse emërimi i tij është i detyrueshëm në bazë të legjislacionit në fuqi. Mandati i Ekspertit kontabël është i rinovueshëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 14

LIGJI I ZBATUESHËM

- 14.1 Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen nga ky Akt Themelimi dhe Statut i Shoqërisë do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

Neni 15

TË NDRYSHME


- 15.1 Ky Statut mund të ndryshohet apo shfuqizohet, ose një Statut i ri mund të miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me Nenin 6.
- 15.2 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat që kjo sjell, do të rregullohen nga dispozitat e Ligjit të Shoqerive Tregtare.
- 15.2 Vula e Shoqërisë do të ketë të shkruar emrin e Shoqërisë dhe Niptin e Shoqërisë.
- 15.3 Të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e këtij Akt Themelimi dhe Statutit dhe mes Shoqërisë, Admnsitratorit dhe Asamblesë së Përgjithshme, do të lihen nën kompetencën ekskluzive të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 15.4 Ky Akt Themelimi dhe Statut i Shoqërisë me Përgjegjesi të Kufizuar 'POLYGLOT - AL' Sh.p.k. përpilohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhen rregullisht nga Ortakët themelues, sot, më datën 30.04.2018, në Tiranë.

ORTAKËT THMELUES

1.


Xhelil BAJRAMI

2.


Imelda DEMBACAJ